



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 620/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Afijete Sada - Glllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, si dhe organizatës BIRN e Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - bërja e fushatës përmes rrjetit social Facebook, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat Anr. 620/2021, e datës 16.10.2021 dhe Anr. 643/2021, e datës 17.10.2021, të parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, organizata BIRN e Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilat kanë kërkuar që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të sanksionohet, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - bërja e fushatës përmes rrjetit social Facebook, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar më datë 16.10.2021 ankesën Anr.620/2021 të subjekti politik LDK, ndërsa më datë 17.10.2021, nga organizata BIRN e Internews Kosova është pranuar ankesa Anr.643/2021, që të dy ankesat e lartcekura, janë parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilat pretendohet se më datë 16 dhe 17 tetor 2021, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe gjatë ditës së votimit kanë vërejtur se Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti, ka postuar në rrjetin e tij zyrtar social Facebook një shkrim përmes të cilit iu është drejtuar qytetarëve të vendit duke i ftuar që ta votojnë subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilin postim shprehimisht ndër të tjera thotë “Duke ju falënderuar për zemërsisht për mikpritjen e jashtëzakonshme gjithandej komunave, fshatrave e lagjeve të Kosovës dhe diskutimeve të pafundme ju ftoj edhe njëherë të votoni Lëvizjen Vetëvendosje me numrin 144 dhe kandidatët e saj” veprime këto që sipas parashtruesit të ankesës janë në

kundërshtim me nenin 36 par. 1 pika b) e LZP-së dhe nenit 8 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 si dhe me Planin Operacional për Organizimin e Zgjedhjeve lokale të KQZ-së. Parashtruesit e ankesës theksojnë se meqë heshtja zgjedhore fillon në ora 00:00 të datës 16 tetor 2021 kryeministri Kurti shkrimin e ka postuar në orët e mëngjesit, kjo vërehet nga provat e bashkangjitura ku vërehet data dhe ora e saktë që kur është bërë postimi në fjalë. Parashtruesi, ankesës Anr.620/2021, i ka bashkangjitur një kopje të vendimit duke pretenduar se për rastet të njëjta paneli e ka sanksionuar parashtruesin e kësaj ankese, me propozime që ankesat të pranohen si të bazuara.

Në përgjigjet në ankesë të subjektit politik LVV, theksohet se kjo ankesë është e pabazuar për faktin se koha e publikimit të postimit për të cilin është paraqitur ankesa është publikuar më datën 16.10.2021 në ora 06:33-06:34 të mëngjesit, ndërsa çështja e heshtjes zgjedhore është rregulluar me nenin 36 paragrafi 1 i LZP-se pika a) dhe b). Në përgjigje në ankesë theksohet se pretendimi i palës ankuese që me vendimin Anr. 461/2021 parashtruesi i ankesës po mundohet që ta vë në lajthitje PZAP-in pasi që në vendimin në fjalë në dispozitivin e tij theksohet se *“Pranohen si të bazuara ankesat e datës 14.02.2021 për shkak të vazhdimit të postimit të materialit zgjedhor ne rrjetin social Facebook ditën e heshtjes zgjedhore”*, me propozim për panelin që ankesat të refuzohen si të bazuara.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale dhe fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Paneli, pasi që vlerësoi pretendimet ankimore, gjeti se ankesat: Anr. 620/2020 dhe Anr. 643/21 të datës 16 dhe 17.10.2021, janë për nga përmbajtja të njëjta, dhe janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, andaj Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kanë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka thyer heshtjen zgjedhore dhe ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore gjatë heshtjes zgjedhore dhe gjatë ditës së votimit edhe më datat 16.10.2021 dhe 17.10.2021.

Paneli vjen në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të ankesës se kemi të bëjmë në këtë rast me thyerjen e heshtjes zgjedhore, sepse heshtja zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021, ka filluar më datë 16.10.2021, në ora 07:00, ndërsa sipas dispozitës ligjore të nenit 36 paragrafi 1 i LZP-se pika b): *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*, e për rastin konkret postimi lëndor në rrjetin social facebook është bërë më datë 16.10.2021, në ora 06:33 në mëngjes, që rezulton të jetë se postimi është bërë 27 minuta para se të fillon heshtja zgjedhore. Për ti vlerësuar edhe më tej pretendimet ankimore, Paneli e ka verifikuar postimin lëndor dhe ka konstatuar se postimi, përveç që është publikuar para se të fillon heshtja zgjedhore siç është konstatuar më lart, ky postim nuk është i sponsorizuar si reklamë që të shfaqet në vazhdimësi-automatikisht edhe gjatë heshtjes zgjedhore e poashtu i njëjti postim nuk ka prova në shkresat e lëndës që është ripërtërirë edhe gjatë heshtjes zgjedhore nga postuesi i njëjtë.

Andaj, nisur nga arsyet e cekura më lartë, PZAP-i ka gjetur se nuk ka pasur thyerje të heshtjes zgjedhore pasi qendrat e votimit janë hapur më datën 17.10.2021 në ora 07:00 të mëngjesit, ndërsa postimi në fjalë është bërë më datën 16.10.2021, në ora 06:33 të mëngjesit, pra para hapjes së qendrave të votimit.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës Anr.620/2021, se me vendimin e Panelit Anr.461/2021 të datës 16.02.2021, në zgjedhjet parlamentare të datës 14.02.2021, e kishte sanksionuar parashtruesin e këtij apeli, Paneli vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me natyrë të njëjtë të shkeljes së supozuar, por dallimi qëndron në atë se të rasti lëndor nuk është postimi që shfaqet në vazhdimësi-automatik, siç ishte paraprakisht ku postimi që është vlerësuar në vendimin e dorëzuar nga ankuesi, ishte shfaqur dhe kishte postime automatike të sponsorizuara edhe në ditët e heshtjes zgjedhore të datës 13 dhe 14 shkurt 2021. Për më tepër,

Paneli vlerëson secilin rast veç e veç dhe me prova shkresore që dallojnë për secilin rast, ngase secili rast i ka specifikat e veta, të vlerësimit dhe mënyrës së vendosjes.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.620/2021 më datë 18.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.